

KËRKESË
Nr.3699/4, datë 5.12.2008

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte dhe drufrutorë), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Sarandë-Krane-Konispol.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë t'i paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Pronarët për të cilët në kolonën “shënime” në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “i pakonfirmuar”, duhet të aplikojnë për regjistrimin e pasurive për të cilat pretendojnë pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Sarandë, në të kundërt nuk do të kompensohen për efekt shpronësimi. Me mbarimin e këtij afati trijavor nga dita e parë e publikimit, për këto pasuri do të kërkohet konfirmim lidhur me titullin e pronësisë pranë ZRPP-së Sarandë.

Pronarët për të cilët në kolonën “shënime” në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 10 351 505 (dhjetë milionë e treqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e pesë) lekë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MPPTT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “SARANDË-KANE-KONISPOL”
Lloji i pasurisë: Kultura drufrutorë nr.(1-15)

Nr.	Pronari			Nr.pas.	Ullinj		Hardhi		Portokalle		Vlera totale lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri		Nr. rrënjëve	Vlera lekë	Nr. Rrënjëve	Vlera lekë	Nr. rrënjëve	Vlera lekë		
1	Bashkëpronësi			917	19	226 000					226 000	Konfirmuar nga ZRPP
2	Bashkëpronësi			1006	10	119 000					119 000	Konfirmuar nga ZRPP
3	Bashkëpronësi			818	6	71 400					71 400	Konfirmuar nga ZRPP
4	Hekuran	Safet	Çokalli	1218	11	106 000					106 000	Konfirmuar nga ZRPP
5	Enver	Refat	Çokalli	1240	4	38 400					38 400	Konfirmuar nga ZRPP
6	Sefedin	Qerim	Veshi	1228	2	19 600					19 600	Konfirmuar nga ZRPP
7	Sazan	Hajri	Mane	1239	10	48 500					48 500	Konfirmuar nga ZRPP
8	Fiqiri	Kaso	Kaso	1266	5	24250					24 250	Konfirmuar nga ZRPP
9	Daut		Brinja	117	3	28 800					28 800	Konfirmuar nga ZRPP
10	Bashkëpronësi			628	25	240 000					240 000	Pakonfirmuar
11	Bashkëpronësi			918	12	115 200					115 200	Pakonfirmuar
12	Resul		Balliu	139/3			6	2700			2700	Konfirmuar nga ZRPP
13	Spiro	Mico	Grema	318/2					5	37 720	37 720	Konfirmuar nga ZRPP
14	Vangjel		Fundo	120/1					4	30 176	30 176	Konfirmuar nga ZRPP
15	Bashkëpronësi			531					50	336 200	336 200	Konfirmuar nga ZRPP
		Totali			107	1037150	6	2700	59	404 096	1443946	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MPPTT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR “SARANDË-KANE-KONISPOL”.

Lloji i pasurisë: Objekte

Nr.	Pronari			Nr. pas.	Objekt lloji	Qyteti/Fshati	Vlera totale lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri					
1	Kosta	Foto	Xhaferri	274	Lokal	Livadhja	1499540	Konfirmuar nga ZRPP
2	Sotir	Spiro	Thanasi	897	Lokal	Çlirim	4556233	I pakonfirmuar
3	Sotir		Qirjo		Lokal	Krane	2851786	I pakonfirmuar
Totali							8907559	